



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:014478

Datë: 03.03.2022

Numri i dokumentit: 02775217

**P.nr.108/22**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari i vetëm gjykues Gani Kastrati, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hilmi Elshani, në çështjen penale kundër të akuzuarëve: L.U. dhe B.U. që të dytë nga fshati .... Komuna e Prizrenit, për shkak të dy veprave penale dhe atë: sulm në bashkëkryerje nga neni 184 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë në bashkëkryerje nga neni 321 par.1 lidhur me neni 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamentit të Përgjithshëm PP/II.nr.168-12/22 të datës 04.02.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Fatos Ajvazi, të akuzuarve të lartcekur dhe mbrojtësve të tyre av.Drenusha Berisha dhe av.Fatbardha Elezkurtaç, që të dyjat nga Prizreni, si dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar av.Esat Gutaj nga Prizreni, me datë 09.02.2022, morri dhe publikisht shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **Të akuzuarit:**

**I. L.U.**, i lindur me datë .... nga i ati J.dhe e ëma Sh. e lindur A. në Prizren, tani me vendbanim në fshatin .... Komuna e Prizrenit, i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal të letërnjoftimit .... qiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **ka qenë në paraburgim prej datës 24.01.2022 deri me datën 09.02.2022.**

**II.B.U.** i lindur më .... nga i ati B. dhe e ëma B. e vajzërisë A. nga Prizreni, tani me vendbanim në fshatin .... Komuna e Prizrenit, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, babai i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, me numër personal të letërnjoftimit .... shtetas i Republikës së Kosovës, **ka qenë në ndalim në stacioni policor prej datës 31.01.2022 gjerë më 02.02.2022.**

### **JANË FAJTOR**

Me datë 22.01.2022, rreth orës 00.55 pas mesnate, në rr."Ahmet Prishtina" në Prizren, ne bashkëveprim edhe me të pandehurit B.U. dhe B.M. të cilët aktualisht janë në arrati, me dashje përdorin forcën ndaj të dëmtuarit L.M. në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshjeje paraprake që kishin në mes veti, derisa i dëmtuari L. ishte i ndalur me automjetin e tij, të pandehurit fillimisht tentojnë ta nxjerrin të dëmtuarin nga vetura, e me pas i pandehuri L.U. me nje shkop druri e godet te dëmtuarin L. ne kokë dhe trup e me pas edhe te pandehurit B1.. dhe B.2. e godasin me mjete te forta-shkop druri të dëmtuarin L. ne pjesë të ndryshme të trupit por që nuk i shkaktojnë dëmtime të dukshme trupore

**Këso dore në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Sulm nga neni 184 par.2 lidhur me nenin 31 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovës (KPRK).**

Me datë, kohë, vend të njëjtë si në dispozitivin e I-rë të këtij aktvendimi, dëmton pasurinë e personit tjetër, konkretisht automjetin e të dëmtuarit L.M. në atë mënyrë që pas përfundimit të përleshjes fizike mes tyre, ne shenjë revolte me mjete të forta e godasin automjetin duke ia thyer xhamat, me ç'rast me këtë veprim të dëmtuarit i shkaktojnë dëm material.

**Këso dore në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 lidhur me nenin 31 i Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëshënuara dhe neneve 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 44, 69, 71 par.1 pika 1.3 të KPRK-së dhe nenin 365 të KPP-së, të akuzuarëve ia shqipton:

## G J Y K O N

### **Për të akuzuarin L.U.**

Për veprën penale **nën 1.** të dispozitivit të aktgjykimit me **dënim me burgim prej 6 (gjashtë) muajve**, por i njëjti në bazë të nenit 44 të KPRK-së dhe me pëlqimin të dënuarit dhe mbrojtëses të tij dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i zëvendësohet **me dënim me gjobë në shumën prej 800 € ( tetëqind euro)**, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në **paraburgim prej datës 24.01.2022 gjerë më 09.02.2022, gjithësejt 17 ditë**, të cilën i akuzuari është i obliguar që të paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si dhe **dënim me gjobë** për veprën penale **nën 2.** të dispozitivit të aktgjykimit në shumën prej 300 € (treqind euro), në të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që të paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Andaj, gjykata konforme dispozitave te nenit 76 par.2 pika.2.4 të KPRK-së, për veprat e lartëcekura penale të akuzuarit ia shqipton **dënimin unik me gjobë në shumën prej 1,100 € (njëmijë e njëqind euro)**, në të cilin dënim me gjobë do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës **24.01.2022 gjerë më 09.02.2022, gjithësejt 17 ditë**, e nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim, i njëjti do ti zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur 20 € (njëzet euro) për një ditë burgim, përkatësishtë 38 (tridhjetë e tetë) ditë burgim.

## **Për të akuzuarin B.U.**

Për veprën penale **nën 1.** të dispozitivit të aktgjykimit me **dënim me burgim prej 6 (gjashtë) muajve**, por i njëjti në bazë të nenit 44 të KPRK-së dhe me pëlqimin të dënuarit dhe mbrojtëses të tij dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i zëvendësohet **me dënim me gjobë në shumën prej 800 € ( tetëqind euro)**, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe **koha e kaluar në ndalim në stacioni policor prej datës 31.01.2022 gjerë më 02.02.2022, gjithësejt 2 ditë**, të cilën i akuzuari është i obliguar që të paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si dhe **dënim me gjobë** për veprën penale **nën 2.** të dispozitivit të aktgjykimit në shumën prej 300 € (treqind euro), në të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që të paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Andaj, gjykata konforme dispozitave të nenit 76 par.2 pika.2.4 të KPRK-së, për veprat e lartëcekura penale të akuzuarit ia shqipton **dënimin unik me gjobë në shumën prej 1,100 € (njëmijë e njëqind euro)**, në të cilin dënim me gjobë do ti llogaritet edhe **koha e kaluar në ndalim në stacioni policor prej datës 31.01.2022 gjerë më 02.02.2022, gjithësejt 2 ditë**, e nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim, i njëjti do ti zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur 20 € (njëzet euro) për një ditë burgim, përkatësisht 53 (pesëdhjetë e tre) ditë burgim.

Obligohen gjithashtu të akuzuarit, që t' i paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 euro veç e veç dhe emër të kompenzimit të viktimave krimet në shumën prej 30 euro veç e veç, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzë nën PP/II.nr.168-12/22 të datës 04.02.2022, kundër të akuzuarëve: kundër të akuzuarëve: L.U. dhe B.U. që të dytë nga fshati .... Komuna e Prizrenit, për shkak të dy veprave penale dhe atë: sulm në bashkëkryerje nga neni 184 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë në bashkëkryerje nga neni 321 par.1 lidhur me neni 31 të KPRK-së, të cilët në shqyrtimin fillestar të gjithë të akuzuarit të lartëcekur kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat ngarkohen sipas aktakuzës.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.09.02.2022, në prezencën e palëve është lexuar aktakuza nga prokurori i shtetit, të akuzuarit kanë deklaruar se e kanë kuptuar akuzën dhe e pranojnë fajësinë për veprat penale që i vihet në barrë.

**Prokurori i shtetit Fatos Ajvazi, ka deklaruar se:** mbetet në tërësi pranë aktakuzës, andaj nga provat që janë në aktakuzë konsideron se të akuzuarit në mënyrë vullnetare kanë pranuar fajësinë për të dy pikat e aktakuzës, ashtu që i propozon gjykatës që të akuzuarit të shpall fajtor dhe të dënon sipas ligjit.

**I akuzuari L.U. ka deklaruar se,** e pranon fajësinë sipas pikave të aktakuzës, është i penduar për veprimet që i ka bërë, mëtutjesh shton se me të dëmtuarin janë pajtuar po ashtu i është kompenzuar për dëmin e shkaktuar dhe se premton po ashtu zotohet se në të ardhmen nuk do përsëris veprime të tilla kundërligjore, pasi që është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, është

mbajtësi i vetëm i familjes, e ka gjendjen të vështirë ekonomiko - i pa punë, andaj e lut gjykatën që të shqipton një dënim sa më të butë.

**Mbrojtësja i të akuzuarit L.U.– av. Fatbardha Elezkurtaj ka deklaruar se,** meqenëse i mbrojturi i tij, me vullnetin e tij të plotë dhe pa trysni pranon fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barë, i njëjti është i penduar dhe se premtion se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprat penale të llojit të tillë, duke pasur parasysh gjendjen shëndetësore, gjendjen e vështirë ekonomike po ashtu i njëjti asnjëherë nuk ka ra ndesh me ligjin, andaj i propozon gjykatës që të i merr parasysh si rrethana lehtësuese në shqiptimin e dënimit.

**I akuzuari B.U. ka deklaruar se,** e pranon fajësinë sipas pikave të aktakuzës, është i penduar për veprimet që i ka bërë, më tutje shton se me të dëmtuarin janë pajtuar po ashtu i është kompensuar për dëmin e shkaktuar dhe se premtion po ashtu zotohet se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla kundërligjore, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, është mbajtësi i vetëm i familjes, e ka gjendjen të vështirë ekonomiko - i pa punë, andaj e lut gjykatën që të shqipton një dënim sa më të butë.

**Mbrojtësja i të akuzuarit B.U. – av. Drenusha Berisha ka deklaruar se,** meqenëse i mbrojturi i tij me vullnetin e tij të plotë dhe pa trysni pranon fajësin për veprat penale të cilat i vihen në barë është penduar dhe duke premtuar që veprimet e tilla apo të çfarëdo lloji tjetër që bien ndesh me ligjin nuk do të i përsërisë. Më tutje mbrojtja ka theksuar se duke marrë parasysh edhe për kompensimin për dëmin e shkaktuar, si dhe rregullimin e mardhënjëve në mes të akuzuarve dhe të dëmtuarit, po ashtu gjendjen e dobët ekonomike të të mbrojturit të tij, andaj i propozon gjykatës që të ketë parasysh si rrethana lehtësuese në llojin dhe lartësinë e dënimit.

**Përfaqësuesi i të dëmtuarit Li.M. av. Esat Gutaj nga Prizreni, ka deklaruar se,** si përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit me përgjegjësi morale, materiale dhe penale e thekson se në zyrën e tij prindi i akuzuarit të parë ia ka shtruar dorën e pajtimit të dëmtuarit dhe është kompensuar në shumë prej 1.800 € dhe se i njëjti nuk ka interes që këta të dënohen po ashtu nuk parashtron kërkesën pronësore juridike sepse i ka rregulluar raportet me familjet e të akuzuarve.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Me datë 22.01.2022, rreth orës 00.55 pas mesnate, në rr. "Ahmet Prishtina" në Prizren, në bashkëveprim edhe me të pandehurit B.U. dhe B.M. të cilët aktualisht janë në arrati, me dashje përdorin forcën ndaj të dëmtuarit L.M. në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshjeje paraprake që kishin në mes veti, derisa i dëmtuari L. ishte i ndalur me automjetin e tij, të pandehurit fillimisht tentojnë ta nxjerrin të dëmtuarin nga vetura, e me pas i pandehuri L.U. me një shkop druri e godet të dëmtuarin L. në kokë dhe trup e me pas edhe të pandehurit B.1. dhe B.2. e godasin me mjete të forta-shkop druri të dëmtuarin L. në pjesë të ndryshme të trupit por që nuk i shkaktojnë dëmtime të dukshme trupore

Me datë, kohë, vend të njëjtë si në dispozitivin e I-rë të këtij aktvendimi, dëmton pasurinë e personit tjetër, konkretisht automjetin e të dëmtuarit L.M. në atë mënyrë që pas përfundimit të përleshjes fizike mes tyre, në shenjë revolte me mjete të forta e godasin automjetin duke ia thyer xhamat, me ç'rast me këtë veprim të dëmtuarit i shkaktojnë dëm material.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit L.U. dhe B.U. të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Gjykata sipas detyrës zyrtare ka gjetur se nuk ekziston

ndonjë provë e pa pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se të akuzuarit, kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprat penale të cilat i vihet në barrë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e tyre, se pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza dhe se të akuzuarit prej fillimit të hetimeve e gjerë në këtë shqyrtim kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat i kanë paraqitur përfaqësuesi i aktakuzës dhe të cilat asnjëherë nuk i kanë kundërshtuar dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarëve formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit të shpall fajtor dhe të gjykon në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarëve, shprehje për keqardhje për rastin që ka ndodh, premtimin e gjykatës së veprimet e tilla nuk do të ndodh më dhe se kanë pasur qëndrimin e tyre korrekt gjatë procesit gjyqësor si dhe janë mbajtësi të familjes. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij dhe ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se shqiptimi i dënimit të tillë do të ndikonë që të akuzuarit të përmbahen nga veprimet kundërligjore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor u muar në kuptim të nenit 450 dhe 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi për programin e kompensimit të viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 39 parag.3 pika 1 të Ligjit me numër 05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2022:014478, 09.02.2022**

**G j y q t a r i**

Gani Kastrati

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2022:014478  
Datë: 03.03.2022  
Numri i dokumentit: 02775217